



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P.241/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 21.04.2017 shqyrtoi ankesën me: \_\_\_\_\_

**Objekt:**

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Myrto Security” shpk në procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozime” me Nr. Ref -66534-02-02-2017 me objekt: “Shërbimi i ruajtjes së objekteve me roje private”, me fond limit 7.495.437,11 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 17.02.2017, nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Fier.

**Ankimues:**

“Myrto Security” shpk  
Lagjia “Kastriot”, Rruga “Brigada e 11 Sulmuese”, godina e Albtelecom Fier

**Autoriteti Kontraktor:**

Spitali Rajonal Fier  
Lagja “1Maj” Rruga “Invalidët e Luftës”

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjeve, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky operator i ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili e ka refuzuar atë, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesave të operatorit ekonomik ankimues.



#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 02.02.2017 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Kërkesë për Propozime*” me Nr. Ref -66534-02-02-2017 me objekt: “*Shërbimi i ruajtjes së objekteve me roje private*”, me fond limit 7.495.437,11 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 17.02.2017, nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Fier.

II.2. Në datën 17.02.2017 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 21.02.2017 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

1. “I.XH. Isufi”	6.828.313,36	kualifikuar
2. “Force Security 2004”	6.828.313,68	kualifikuar
3. “Myrto Security”	6.828.313,68	kualifikuar
4. “Nazeri 2000”	6.828.313,68	kualifikuar

II.4. Në datën 21.02.2017 operatori ekonomik “Myrto Security” shpk është njoftuar përmes sistemit të prokurimeve elektronike për kualifikimin e ofertës së tij.

II.5. Në datën 27.02.2017 operatori ekonomik ankimues “Myrto Security” shpk, ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar kualifikimin e ofertuesve ekonomikë pjesëmarrës në tender, me argumentat si më poshtë:

[...]

1. Në datën 17.02.2017 paraqitëm ofertën në proceurën e prokurimit të mësipërme. Në datën 21.02.2017 në mënyrë elektronike u njohëm me vendimin e kvo-së për klasifikimin e kandidatëve sipas të cilit oferta që kemi paraqitur është pranuar dhe klasifikuar në vend të dytë me të njëjtën vlerë me tre oe të tjerë. Vlerësojmë se ky vendim i KVO-së është pjesërisht i drejtë pasi ofertat e oe “Nazeri 2000” shpk dhe “I.XH.Isufi” nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara në dst dhe si të tilla duhet të refuzohen. Sipas klasifikimit të datës 21.02.2017 operatori “I.XH.Isufi” ka paraqitur vlerën totale të ofertës 6.828.313,36 leke pa tvsh vlerësojmë se oferta e këtij oe vjen në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore mbi bazën e të cilave përcaktohet cmimi për njësi si dhe praktikën e konsoliduar të KPP-së.
2. [...]Referuar dispozitave ligjore dhe kriterëve të përcaktuara në dst ofertat e oe “Nazeri 2000” shpk dhe “I.XH.Isufi” të konsideroheshin të vlefshme duhet ti provonin ak-së se :  
Ka të licencuar 15 punonjës shërbimi dhe këto certifikata duhet të jenë të lëshuara brenda afatit 4 vjecar pra të jenë lëshuar jo më parë se datë 06.02.2013.
3. oe “Nazeri 2000” shpk dhe “I.XH.Isufi” nuk kanë në pronësi armë sa numri i vendrojeve të përcaktuara në shtojcën 11 të dst-ve elementë që lidhet në mënyrë të drejtëpërdrejtë edhe me cmimin e ofertës pasi për armët që nuk kanë në pronësi kanë detyrimin e llogaritjes të shpenzimeve për armatim sipas legjislacionit në fuqi.
4. Nuk kanë përmbushur detyrimet financiare për taksat vendore sipas vendodhjes së ushtrimit të aktivitetit të regjistruar në QKB për vitin 2016 sipas përcaktimit në shtojcën 7.
5. Nuk kanë realizura shërbime të ngjashme gjatë tre viteve të fundit në objekt dhe vlerë provuar kjo sipas përcaktimit të shtojcës 7.
6. Nuk kanë në pronësi dhe në përdorim automjete sipas dokumentacionit dhe afatit të vlefshmërisë së tyre sipas përcaktimit të shtojcës 7.
7. Nuk kanë numrin e punonjësve të siguruar sipas dokumentacionit të kërkuar në shtojcën 7.

II.6. Në datën 01.03.2017, nëpërmjet shkresës me nr. 880 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues, duke e refuzuar ankesën.

II.7. Në datën 13.03.2017 pala ankimuese “Myrto Security” shpk, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me argumentat si më poshtë:

[...]

Në datën 17.02.2017 paraqitëm ofertën në proceurën e prokurimit të mësipërme. Në datën 21.02.2017 në mënyrë elektronike u njohëm me vendimin e kvo-së për klasifikimin e kandidatëve sipas të cilit oferta që kemi paraqitur është pranuar dhe klasifikuar në vend të dytë me të njëjtën vlerë me tre oe të tjerë. Vlerësojmë se ky vendim i KVO-së është pjesërisht i drejtë pasi ofertat e oe

“Nazeri 2000” shpk dhe “I.XH.Isufi” nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara në dst dhe si të tilla duhet të refuzohen në datën 24.02.2017 parashtruar ankesë pranë autoritetit kontraktor (dorëzuar nëpërmjet shërbimit postar). Me shkresë nr. 880prot datë 01.03.2017 (depozituar në shërbimin postar datë 03.03.2017 dhe na është komunikuar në datën 06.03.2017. Autoriteti kontraktor na vë në dijeni se ankesa jonë është refuzuar. Duke vlerësuar se dhe ky vendim i ak-së nuk është i drejtë parashtrorjëm pretendimet tona: Sipas klasifikimit të datës 21.02.2017 operatori “I.XH.Isufi” ka paraqitur vlerën totale të ofertës 6.828.313,36 leke pa tvsh vlerësojmë se oferta e këtij oe vjen në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore mbi bazën e të cilave përcaktohet cmimi për njësi si dhe praktikën e konsoliduar të KPP-së.[...] Nga sa parashtruar kërkojmë:Pranimin e ankesës ssonë si dhe shfuqizimin e pjesshëm të vendimit të datës 21.02.2017 të KVO-së përsa i përket pranimit /kualifikimit të ofertës së oe “I.XH.Isufi”

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. 1031 prot., datë 17.03.2017, protokolluar me tonën me nr.425/2 datë 21.03.2017 me objekt “Dërgohet informacion”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “Myrto Security” shpk, për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “I.XH.Isufi” me arsyetimin “Sipas klasifikimit të datës 21.02.2017 operatori “I.XH.Isufi” ka paraqitur vlerën totale të ofertës 6.828.313,36 leke pa tvsh vlerësojmë se oferta e këtij oe vjen në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore mbi bazën e të cilave përcaktohet cmimi për njësi si dhe praktikën e konsoliduar të KPP-së.[...] Nga sa parashtruar kërkojmë:Pranimin e ankesës ssonë si dhe shfuqizimin e pjesshëm të vendimit të datës 21.02.2017 të KVO-së përsa i përket pranimit /kualifikimit të ofertës së oe “I.XH.Isufi”, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 1 “Formulari i Ofertës” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet se:

Oferta ekonomike te jete e shoqeruar me perlllogaritjen per koston mujore duke perfshire te gjitha shpenzimet sipas tabelës :

Nr	Emertimi	Sasia	Cmimi per njesi	vlera ne nje muaj
1	Paga Baze			
2	Paga per veshtiresi turni II			
3	Paga per veshtiresi turni III			
4	Paga per dite festash 25%			
5	Shuma e (1+,,,,,+4)			
6	Sigurime Shend,shoqerore 16,7%			

7	Shpenzime armatimi			
8	Shpenzime administrative, nderlidhje			
9	Shpenzime per uniforme			
10	Shuma bruto			
11	Fitimi I Shoqerise			
12	Shuma neto			

III.1.2. Në shtojcën 8 “Specifikimet Teknike” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet se:

Skicimet, parametrat teknik etj:

Ne total numri i rojeve eshte 14.62 roje per 4 vendroje.

Nr	Emertimi	Nr. I vend - rojeve	Nr. Rojeve	Sherbimi	Orari
1	Spitali Godina Qendrore	1	4.88	24 ore	24 ore
2	Godina e Pediatrise	1	1.62	8 ore (Turni i III)	T.III 22.00- 6.00
3	Godina e Maternitetit	1	3.24	16ore(Turni II+III)	T.II 14.00-22.00 T.III 22.00- 6.00
4	Poliklinika e Specialiteteve	1	4.88	24 ore	24 ore

Pershkrimi I ofertes :



Nr	Emertimi	Sasia	Cmimi per njesi	vlera ne nje muaj	Vlera per 10 muaj
1	Paga Baze				
2	Paga per veshtiresi turni II				
3	Paga per veshtiresi turni III				
4	Paga per dite festash 25%				
5	Shuma e (1+,,,,,+4)				
6	Sigurime Shend,shoqerore 16,7%				
7	Shpenzime armatimi				
8	Shpenzime administrative, nderlidhje				
9	Shpenzime per uniforme				
10	Shuma bruto				
11	Fitimi I Shoqerise 2%				
12	Shuma neto				

Perllogaritja eshte per Afatin 10 muaj nga data e lidhjes se kontrates 01.03.2017 - 31.12.2017.

### Shenim

Operatorët ekonomik duhet të plotësojnë ofertat e tyre duke patur parasysh kërkesat dhe fondin limit të përcaktuar në tabelën e dokumentave standarte të tenderit.

- Numri i rojeve për të realizuar shërbimin 14.62 roje me 4 vendroje sipas turneve.

- Rojet duhet të kenë në përdorim për realizimin e shërbimit të ruajtjes, radio komunikimi.
- Rojet duhet të jenë të pajisur me uniformë, sipas legjislacionit në fuqi.

Sqarim: Në ofertë të jenë të përfshira të gjitha shpenzimet e përgjithshme, për uniformat (veshmbathjen), armatim, ndërlidhje (si radiomarrës etj), shpenzimet për pagën e rojeve, shtesat mbi pagën për turnin e dyta (ora 19.<sup>oo</sup> - 22<sup>oo</sup>), shtesat mbi pagën për turnin e tretë (ora 22.<sup>oo</sup> - 06<sup>oo</sup>), shtesat mbi pagën për ditët e pushimeve dhe ditët e festave, sigurimet shoqerore dhe shëndetësore si dhe të gjitha detyrimet fiskale që parashikon legjislacioni në fuqi.

Te disponoj Grup te gatshem per te nderhyre, per perballimin e situatave emergjence qe mund te krijohen .

III.1.4. Në shtojcën 10 “Shërbimet dhe grafiku i ekzekutimit” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet se:

Shërbimi që kërkohet:

Sherbimi do te kryhet cdo dite te javes 7/7 sherbimi do te jete I ndare sipase grafikut perkates te paraqitur ne tabelen e meposhteme

Ne total numri i rojeve eshte 14.62 roje per 4 vendroje.

Nr	Emertimi	Nr. I vend-rojeve	Nr. Rojeve	Sherbimi	Orari
1	Spitali Godina Qendrore	1	4.88	24 ore	24 ore
2	Godina e Pediatrise	1	1.62	8 ore (Turni i III)	T.III 22.00- 6.00
3	Godina e Maternitetit	1	3.24	16ore(Turni II+III)	T.II 14.00-22.00 T.III 22.00- 6.00
4	Poliklinika e Specialiteteve	1	4.88	24 ore	24 ore

**Public Health Sector**

Afatet e ekzekutimit:

Me lidhjen e kontrates deri ne 31.12.2017

III.1.5. Në shtojcën 11 “Termet e Referencës” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet se:

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Objekti I ketij prokurimi eshte ruajtja me roje private te Spitalit Rajonal Fier per objektet e Spitalit Rajonal Fier (kater godinat) per vete specifiken e shërbimit qe ofron ky institucion . Sherbimi do te kryhet sipas grafikut.Totali I numrit te rojeve do te jete 14.62

Detyrat:

Garantimi I paprekshmerise se objekteve automjeteve, vlerave monetare e materiale te perfshira ne objektet e institucionit, garantimi i nje pune normale per punonjesit qe punojne ne keto objekte dhe

shmangja e konflikteve te mundeshme pacient-personel, ne keto raste rojet private duhet te nderhyjne.

Ruajtja e territoreve te objekteve me qellim qe te mos lejohet hyrje daljet ne objekte te personave te paautorizuar si dhe nderhyrja e personave keqebeser dhe parandalimin e veprimeve qe shkaktojne demtimin e prones dhe pervetesimin e saj, respektimi i orarit te vizitave ne pavione per kete rojet private duhet te disiplinohen mbarvajtjen e sherbimeve perkatese e te hyrje daljeve.

Shperndarja:

Shperndarja e Sherbimit te Rojeve Private do te jete sipas grafikut te mesiper te miratuar nga Drejtoria e Spitalit Rjonal Fier.

Vendi i kryerjes se sherbimeve: Godinat e Spitalit Rajonal Fier

III.1.6. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.*

III.1.7. Në Ligjin nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, neni 18, gërma “g” është përcaktuar: *“Paga e punonjësit të rolit bazë të shërbimit të jetë minimalisht 50 për qind më e madhe se paga minimale e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.*

III.1.8. Në VKM nr. 573, datë 03.7.2013 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, përcaktohet shprehimisht: *“Paga bazë minimale, mujore, për punonjësit, në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person, juridik a fizik, vendas ose i huaj, të jetë 22.000 (njëzetë e dy mijë) lekë. Paga bazë minimale, mujore, jepet për 174 orë pune në muaj, të kryera gjatë kohës normale të punës. Paga bazë minimale orare të jetë 127 (njëqind e njëzet e shtatë) lekë”.*

III.1.9. Në nenin 81 të “Kodit të Punës”, është parashikuar: *“Çdo orë pune e kryer nga ora 19.00 deri në 22.00 jep të drejtën e një shtesë mbi pagë jo më pak se 20% dhe çdo orë pune e kryer midis intervalit 22.00 dhe 6.00 jep të drejtën e një shtesë mbi pagë jo më pak se 50%”, ndërsa referuar nenin 87, po këtu, “puna e kryer ditën e pushimit javor ose në ditët e festave zyrtare kompesohet me një shtesë page jo më pak se 25% ose me një pushim të barabartë me kohëzgjatjen e punës së kryer plus një pushim shtesë jo më pak se 25 për qind të kohëzgjatjes së kësaj pune, që merret një javë para ose pas kryerjes së saj. ”*

III.1.10. Kontributi i detyrueshëm për sigurimet shoqërore e shëndetësore i të punësuarit, duke filluar nga pjesa e punëdhënësit, është 16,7%, referuar VKM-së nr.77, dt. 28.01.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”.

III.1.11. Nisur nga baza ligjore e sipërcituar, kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor. Komisioni i Prokurimit Publik pas përlogaritjeve të kryera, konstaton se oferta ekonomike e operatorit ekonomik “I.XH.Isufi” shpk, në total është nën koston e lejuar ligjore pasi oferta e paraqitur është përlogaritur jo në përputhje me detyrimet e përcaktuara nga legjislacionin në fuqi për pagën minimale ligjore, shtesat mbi pagë për turnin e II dhe të III, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në masën 16.7 %, e rrjedhimisht nuk mjaftojnë për mbulimin e shpenzimeve për periudhën e kërkuar të kryerjes së shërbimit të ruajtjes me roje në përputhje me aktet ligjore dhe nëligjore në fuqi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “Myrto Security” shpk qëndron.

Për sa më sipër në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, me shumicë votash

#### Vendos

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Myrto Security” shpk, për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozime” me Nr. Ref -66534-02-02-2017 me objekt: “Shërbimi i ruajtjes së objekteve me roje private”, me fond limit 7.495.437,11 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 17.02.2017, nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Fier.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për kualifikimin e operatorit ekonomik “I.XH. Isufi” shpk duke e skualifikuar këtë operator.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të verë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Myrto Security” shpk.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 425 Prot; Datë 13.03.2017**

#### KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar  
Hektor Balluku

Anëtar  
Kleves Janku

Anëtar  
Odise Moçka

Kryetar  
Evis Shurdha